



*Njoftimi, miratimi i statusit si viktimë dhe zhdëmtimi përbëjnë të drejtat dhe interesat personale të viktimave në procedura penale para Dhomave të Specializuara të Kosovës.*

*Për jetësimin e të drejtave dhe interesave të lartpërmendura, viktimave mund t'u lejohet pjesëmarrja në procedura gjyqësore para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Pjesëmarrja realizohet nëpërmjet një mbrojtësi.*

#### KUSH PËRKUFIZOHET VIKTIMË?

Një person fizik i cili beson se ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një veprë penale të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, mund të bëjë kërkesë për miratimin e statusit të viktimës pjesëmarrëse.

Për miratimin e statusit të viktimës para Dhomave të Specializuar të Kosovës, kërkuesi duhet të paraqesë prova të mjaftueshme për dëmin e pësuar si pasojë e drejtpërdrejtë e cilësdo veprë penale nga aktakuza. Vendimin mbi kërkesën e merr një panel gjykatësish.

#### SI, KU DHE KUR PARAQITET KËRKESA?

Viktimat mund të paraqesin kërkesë për pjesëmarrje pasi një aktakuzë e konfirmuar të jetë bërë publike. Ata që kanë pësuar dëm si pasojë e një veprë penale të përmendur në aktakuzë, mund të vendosin që të paraqesin kërkesë dhe të marrin statusin e viktimës pjesëmarrëse.

Pas publikimit të një aktakuze të konfirmuar, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave e Zyrës Administrative nxjerr formularët e kërkesës dhe mundëson informacion më të hollësishëm për kriteret e pranimit si viktimë pjesëmarrëse në procedura, si edhe për procesin e paraqitjes së kërkesës.

Kërkesat duhet t'i dorëzohen Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave në kohë të mjaftueshme para nisjes së gjyqimit.

Të gjitha kërkesat e viktimave dhe komunikimet me viktimat e mundshme dhe ndihmësit e tyre, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave do t'i trajtojë si konfidenciale.

#### KONTAKT

*Për çfarëdo pyetjesh, ju lutemi kontaktoni Zyrën për Pjesëmarrje të Viktimave në: [vpo@scp-ks.org](mailto:vpo@scp-ks.org), ose në:*

*Kosovo Specialist Chambers*

*P.O. Box 47  
2501 CA, The Hague, The Netherlands*

## SI MUND TË MARRIN PJESË VIKTIMAT?

Personave që u miratohet statusi i viktimës pjesëmarrëse në procedura, caktohen në një ose më shumë grupe, në përputhje me vendimin e panelit të gjykatësve. Gjatë marrjes së vendimit në lidhje me miratimin e statusit të viktimës dhe modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave në procedura, gjykatësit duhet të garantojnë se kjo nuk do të ndikojë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procedurave gjyqësore në tërësi.

Për përfaqësimin e një grupi viktimash, Administratori cakton një mbrojtës. Në marrjen e vendimit për caktimin e mbrojtësit merren parasysh **mendimet, interesat dhe parapëlqimet e viktimave pjesëmarrëse**. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave administron sistemin e pagesave për mbrojtësit.

Mbrojtësit i informojnë viktimat gjatë gjithë procedurës gjyqësore dhe **kërkojnë mendimet e dëgjojnë shqetësimet e tyre** në lidhje me procedurën gjyqësore me qëllim që këto mendime e shqetësime t'ua paraqesin gjykatësve.

Gjatë përfaqësimit të një grupi viktimash, mbrojtësi i tyre mund:

- të jetë i pranishëm në seanca gjyqësore dhe të bëjë parashtrime gojore ose me shkrim, si edhe t'u bëjë pyetje dëshmitarëve, sa herë që një panel gjykatësish e konsideron të nevojshme për mbrojtjen e intereseve dhe të drejtave të viktimave;
- të ketë qasje në materialin e nevojshëm për përfaqësimin e grupit të viktimave sikurse është përcaktuar nga paneli i gjykatësve;
- të bëjë deklaratë hyrëse dhe përmbyllëse gjatë gjykimit;
- t'i kërkojë panelit të gjykatësve që të urdhërojë paraqitjen e provave dhe të dëshmimeve gojore të dëshmitarëve në lidhje me ndikimin e krimeve mbi viktimat pjesëmarrëse në procedura, në qoftë se aspekte të tilla nuk janë qartësuar siç duhet gjatë gjykimit.

Në fund të procesit gjyqësor, paneli i gjykatësve mund të nxjerrë vendim mbi dëmet, humbjet dhe lëndimet e viktimave, i cili mund të jetë bazë për vendimin mbi zhdëmtimin.

## LISTA E MBROJTËSVE

Më 6 nëntor 2017, Administratorja nxori Direktivën për Mbrojtësit, pas miratimit prej Kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës në këshillim me gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Kjo Direktivë rregullon kriteret e pranueshmërisë për përfshirje në Listën e Mbrojtësve, detyrimet në vijimësi të mbrojtësve të pranuar në Listën e Mbrojtësve, si dhe modalitetet e vetëtërheqjes dhe të përjashtimit nga Lista e Mbrojtësve. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave përpilon dhe administron një listë mbrojtësish që përmbushin kriteret e përfaqësimit të një grupi viktimash para Dhomave të Specializuara ("Lista e Mbrojtësve të Viktimave").

Vetëm mbrojtësit e pranuar në Listë përmbushin kriteret për përfaqësimin e një grupi viktimash para Dhomave të Specializuara.

Kriteret për pranim në Listën e Mbrojtësve janë:

- kompetencë dhe përvojë e dëshmuar në fushën e së drejtës dhe procedurës penale vendore dhe/ose në fushën e së drejtës dhe procedurës penale ndërkombëtare;
- të paktën dhjetë (10) vjet dhe si bashkëmbrojtës, të paktën shtatë (7) vjet përvojë të dëshmuar përkatëse, qoftë si avokat i mbrojtjes apo i viktimave, si prokuror, gjykatës, ose në një funksion të ngjashëm në procese penale; duke përfshirë për pranim në

Listën e Mbrojtësve të Viktimave, të paktën pesë (5) vjet përvojë përkatëse pune në çështje penale me viktimë, përfshirë viktimat e cenushme;

- gjatë gjithë kohës që është i përfshirë në Listën e Mbrojtësve, kërkuesi vazhdon të jetë anëtar i shoqatës së avokatëve ose i një institucioni të ngjashëm të vendit të tij, ose gjykatës apo prokuror në varësi të një autoriteti mbikëqyrës;
- aftësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara (shqip, serbisht, anglisht);
- kërkuesi nuk është shpallur fajtor në procese penale, ose ndryshe ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore në procedime disiplinore përkatëse kundër tij në ndonjë forum shtetëror ose ndërkombëtar;
- kërkuesi nuk ka pasur sjellje të pandershme ose diskredituese për një mbrojtës, në dëm të administrimit të drejtësisë, ose që ka gjasë të pakësojë besimin e publikut në Dhomat e Specializuara, ose në administrimin e drejtësisë, ose që diskrediton emrin e Dhomave të Specializuara.

Nëse kundër kërkuesit janë në kryerje e sipër procedime, hetime ose verifikime penale, disiplinore ose të tjera, vendimi mbi pranimin shtyhet deri në daljen e vendimit të formës së prerë prej procedurave të përmendura më parë.

## SI BËHET KËRKESA

**Formulari i kërkesës dhe Udhëzimet gjenden në adresën e mëposhtme në Internet:**  
[www.scp-ks.org/sq/dhomat-e-specializuara/viktimat](http://www.scp-ks.org/sq/dhomat-e-specializuara/viktimat)